

VENDIM
Nr.399, datë 27.3.2008

PËR MIRATIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË RREGULLT DHE TË ANËTARËVE TË PËRHERSHËM TË AKADEMISË SË SHKENCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7 e 16 të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshme dhe të Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e rregullt dhe anëtarët e përhershëm të Akademisë së Shkencave përfitojnë një shpërblim mujor, për titullin “Akademik”, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj.
2. Kjo pagesë të bëhet nga Akademia e Shkencave dhe të përballohet nga buxheti vjetor, miratuar për këtë institucion.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha